



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1251\_11\_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **05.12.2014**.

**në seancën e mbajtur më datë 23 dhjetor 2014, nxorri këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A.B.H , parashtruesi i ankesës A.H. me shifër DPR - 90094512 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1251\_11\_14 i datës 17.11.2014.

**Arsyetim**

Me datë 05.02.2014 punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEDS-it kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 1301705596 me gjendje: TL=00000 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=00000 kWh (tarifa e ulët). Departamenti i faturimit në KEDS me datë 03.04.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2014 me shpenzim prej **3924 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **343.75€**.

Me datë 25.04.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe duke u bazuar në procesverbalin e inspektimit nr. 1018102 të datës 11.03.2014 duke bërë korigjimin e faturave për periudhën 02/2014 deri në 03/2013 në vlerë **-20.70€**.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it me datë 27.05.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas kësaj ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe me datë 17.11.2014 ka nxjerrë vendim duke e **refuzuar** ankesën e konsumatorit pasi që i njëjti nuk ka ofruar ofruar prova të mjaftueshme lidhur me ankesën e tij.

Konsumatori në ankesën e tij kundërshton vendimin e DMK-së si të pabazë ku thekson se të gjeturat e theksuara në vendim nuk mbështeten në argumente bindëse për të dëshmuar këtë vendim. Konsumatori poashtu thekson se mbetet pran thënieve të tij të theksuara edhe me herët në ankesë



dhe shton se kilovatët e ngarkuar nuk janë shpenzuar nga ana e ime dhe se nuk kam njohuri se ata kilovat a janë regjistruar në mënyrë të rregullt apo jo.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23 dhjetor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka nxjerr vendim në dëm të këtij konsumatori.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe pikën e kundërshtimit lidhur me kontestimin e faturës se muajit 03/2014 dhe për këtë ka konstatuar se KEDS nuk ka respektuar saktë dispozitat ligjore të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurën e Leximit dhe Faturimi, ku konsumatorët duhet të lexohen për çdo muaj dhe duhet të faturohen sipas shpenzimeve mujore të regjistruara në njehsorin elektrik, e jo të lejojnë grumbullim të shpenzimit. Bordi gjithashtu ka vërejtur fatura e energjisë elektrike e muajit 03/2014 ka ardhur si rezultat i mos leximit të rregullt të pikës matëse nga lexuesi nga periudha e regjistrimit të njehsorit elektrik 05.02.2014 e deri në periudhën 03/2014, pasi që lexuesi i KEDS-it në periudhën 02/2014 nuk ka bërë lexim të pikës matëse por gjithë shpenzimin e ka evidentuar në muajin 03/2014.

Lidhur me kërkesën e korigjimit të faturës 03/2014 Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se DMK ka vepruar drejt sa i përket kalkulimit dhe shpërndarjes se kilovatëve e cila është bërë në përputhje të plotë me rregullat në fuqi. Periudha e shpërndarjes së energjisë elektrike është marr duke u bazuar në procesin e regjistrimit të njehsorit elektrike të KEDS-it të datës 05.02.2014 ku gjendja e njehsorit elektrik nr. 1301705596 në datën e regjistrimit ka qenë TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh dhe deri në periudhën e leximit dhe faturimit 03/2014. Kësisoj është vërtetuar se përkundër kësaj konsumatori nuk është dëmtuar në vlerë financiare, por që me këtë është theksuar se KEDS duhet t'i aplikoi rregullat e lartshënuara në mënyrë që leximi dhe faturimi i konsumatorëve të bëhet për çdo muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe çështjen e ngritur nga konsumatori lidhur me shkyçjet që i janë bërë nga ana e KEDS, sa ankesa ka qenë ende në shqyrtim në ZRRE, me ç'rast ka gjetur se DMK, ka marr veprimet e duhura ligjore siç parashihen me dispozitat ligjore në Rregullën për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë, ndërsa për KEDS-in është kërkuar që për raste të tilla të merren masa ligjore në mënyrë që të mos pengohen konsumatorët me shkyçje.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.12.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1251\_11\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar